

P. nr.389/16

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i përgjithshëm**, Gjyqtarja **DIANA SINA**, me sekretaren juridike Lamije Kuqi, në çështjen penale kundër të akuzuarit A. A. nga fsh. I. K. Deçan, për shkak të veprës penale, rrezikim i trafikut publik, nga neni 378 par.6/1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore-Dep.përgjithshëm në Gjakovë, PP.nr.1522/2015 të datës 07.07.2016, në shqyrtimin publik gjyqësor, të mbajtur më datë **06.12.2016**, në prani të Prokurorit të shtetit Ismet Tofaj, të akuzuarit, të Përfaqësuesit ligjor i të dëmtuarës-të miturës A. K., të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

I akuzuari **A. A.**, i biri i T. dhe i ëmës N., e gjinisë M., i lindur me datën... në fsh.I. K.Deçan, ku dhe tani banon, i pa punë, ka të kryer shkollën e mesme, shqiptar, shtetas i R.së Kosovës, i gjendjes së dobët ekonomike, i martuar-atë 2 fëmijëve.

#### Ë s h t ë f a j t o r:

**Sepse:** Me datën 22.07.2015, rreth orës 22.30 minuta në Gjakovë në rr. "UÇK" në drejtim të rr."Fehmi Agani" saktësisht me të arritur tek Stacioni i autobusëve, nga pakujdesia rrezikon trafikun publik duke shkëlur nenin 46, nenin 54 dhe nenin 150 lidhur me nenin 352, të Ligjit për Siguri në Komunikacion Rrugor dhe vënë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë, në atë mënyrë që duke drejtuar automjetin të markës "Opell-Vectra" me targa të regjistrimit... ngjyrë vishnje, nuk ia ka përshtatur shpejtësinë e lëvizjes kushteve dhe rrethanave në rrugë, nuk lëvizë me kujdes të shtuar gjatë afrimit të vendkalimit të shënuar për këmbësor, përkatësisht nuk i jep përparësi kalimi këmbësorës, e cila në momentin kritik ishte duke lëvizur pranë vendkalimit të shënuar për këmbësor nga ana e djathtë në anën e majtë të drejtimit të lëvizjes së automjetit, ku si pasoj me pjesën e përparmë anësorë të anës së djathtë të automjetit e godet në këmbën e majë këmbësoren, tani të dëmtuarën A. K., me ç' rast të dëmtuarës i shkakton lëndime të lehta trupore në këmbën e majtë të cilat lëndime me gjerësisht janë të konstatuara dhe të përshkruara në ekspertizën mjeko-ligjore të dt.06.05.2016 nga eksperti mjeko-ligjor Dr. F. D.

- me çka ka kryer veprë penale, rrezikim i trafikut publik, nga neni 378 par.6/1 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit 4, 41, 49, 50, 51, 73, 378 par.6/1 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPPK-së, i shqipton:

#### DËNIM ME KUSHT

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej **4(katër) muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1(Një) viti**, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

E dëmtuara Përfaqësuesi ligjor i të dëmtuarës-të miturës A. K.-B. K., kompensimin e dëmit mund ta realizon në kontest civil.

Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve procedurale , në emër të ekspertizës së komunikacionit, të paguaj shumën prej **40.88 €**, në emër të akt ekspertimit mjeko ligjor të paguaj shumën prej **20.00 €**, dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **25,00.-€**, e krejt këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjakovë, ka ngritë Aktakuzë PP.nr.1522/15 të datës 07.07.2016, kundër të akuzuarit A. A. nga fsh. I. K. Deçan, për shkak të veprës penale, rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6/1 të KPRK-ës, dhe ka propozuar që i akuzuari të shpallet fajtor, të dënohet sipas Ligjit dhe të obligohet në kompensimin e shpenzimeve gjyqësore.

Para mbajtjes së shqyrtimit fillestar Prokurori i shtetit ka ngritur Aktakuzë me nr. PP.nr.1522/2015, të datës 07.07.2016 duke propozuar që ndaj të akuzuarit A. A. ti nxjerrë urdhër ndëshkimor me të cilin të njëjtit ti shqiptohet një dënim me gjobë, Gjykata ka aprovuar kërkesën e Prokurorit dhe të njëjtin e ka shpallur fajtor dhe e ka dënuar me gjobë në shumë prej 300 Euro, si dhe ka obliguar në kompensimin e shpenzimeve gjyqësore, në emër të ekspertizës së komunikacionit të paguaj shumën prej 40.88 Euro, në emër të ekspertizës mjeko ligjore të paguaj shumën prej 20.00 Euro, dhe në emër të paushallit gjyqësor në shumë prej 25.- Euro, me aktgjykimin P.nr.389/16 të datës 22.09.2016, në afatin ligjor i akuzuari ka parash truar kundërshtim kundër Aktgjykimit - urdhër ndëshkimor të lartë cekur, prandaj Gjykata ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor ndaj të akuzuarit A. A., për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378/6-1 të KPRK-s.

I akuzuari A. A. që në fillim të shqyrtimit gjyqësor lidhur me fajësinë deklaron se e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë në bazë të vullnetit të lirë dhe pa imponim, duke ditur më parë për pasojat dhe favoret e pranimit të fajësisë.

Pasi Gjykata ka fituar bindjen se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë për veprën penale, që i vihet në barrë dhe është i bindur se pranimin e ka bërë në baza vullnetare, duke u mbështetur edhe në faktet dhe provat që i përmban Aktakuza, ka gjetur se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore nga neni 326 par. 4, të KPPK-ës, shqyrtimin gjyqësor e ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve.

Prokurori i shtetit Ismet Tofaj në fjalën përfundimtare deklaroi se, me pranimin e fajësisë që u bë lirshëm dhe vullnetshëm nga i pandehuri, e që ky pranim ka mbështetje edhe në provat materiale në shkresat e lëndës, është vërtetuar mjaftë se i pandehuri A. A. me datë, kohë dhe vend sipas aktakuzës PP.nr.1522/15 të dt. 07.07.2016, ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-ës, e gjykatës i propozoi që të njëjtin ta shpall fajtor të dënoi në bazë të ligjit dhe të obligoi në shpenzimet e procedurës penale, por me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit të ketë parasysh pranimin e fajësisë, pendimin, premtimin se në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm, mos dënushmërinë e tij mëparshme, e sidomos gjendjen e tij të dobët ekonomike, si dhe ndonjë rrethanë tjetër lehtësuese apo rënduese nëse gjen.

Përfaqësuesi ligjor i të dëmtuarës-të miturës A. K. babai i saj B. K., në fjalën përfundimtare deklaron, se nuk i bashkëngjitëm ndjekjes penale, por kërkoi kompensimin e dëmit.

I akuzuari A. A. në fjalën e tij përfundimtare sërish bëri pranimin e fajësisë, deklaroi se pendona pa masë për veprën e kryer, dhe premtoi se në të ardhmen do të jem më i kujdesshëm gjatë drejtimit të automjetit, aksidentin e kam shkaktuar pa dashje, por nga pakujdesia ime, shton se jam në gjendje të dobët ekonomike, jam i papunë, jam punëtor krahu – punëtor fizik herë pas herë kur ka punë, jam mbajtës i vetëm i familjes, jam i martuar baba i 2 fëmijëve, prandaj i propozoi Gjykatës që të merre parasysh këto rrethana me rastin e shqiptimit të dënimit.

Me faktet e ofruara, me provat që bashkëngjiten në shkresat e lëndës, e sidomos me pranimin e fajësisë nga i akuzuari është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, andaj me veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet e veprës penale rrezikim i trafikut publik, nga neni 378 par.6/1 të KPRK-ës, për të cilën veprë i akuzuari është penalisht përgjegjës dhe është ndëshkuar si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Me rastin e matjes së dënimit, Gjykata i ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPRK-ës, të cilat ndikon në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit, si rrethanë lehtësuese, Gjykata ka marrë parasysh pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga i akuzuari, pendimin e tij, sjellje korrekte të akuzuarit në Gjykim, si dhe faktin se i akuzuari më parë nuk ka qenë i dënuar, e sidomos duke marrë parasysh gjendjen e tij ekonomike, pendimin e tij, të gjitha këto rrethana ndikuan që Gjykata ti zbatoi dispozitat e zbutjes së dënimit të parapara me nenin 73 të KPRK-ës, Gjykata të akuzuarit i shqiptoi dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4(katër) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej 1 (Një) viti, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale, me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 41 të KPRK-ës.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 463 par.2 të KPPK-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, është marrë komfor nenit 450 par. 1 dhe 2 nën par.2.1 dhe 2.6, lidhur me nenin 453 të KPPK-se.

Nga sa u tha më lart u vendosë si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,  
P. nr.389/16 më datë 06.12.2016.**

**Sekretarja juridike,  
Lamije Kuqi**

**Gj y q t a r j a  
Diana Sina**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afatin prej **15 ditësh**, nga dita e marrjes së tij në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj Gjykate.